



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Zyrtar për statistika ne zyrën rajonale në Prishtinë
Numri i referencës:	ASK-DRA-001
Tarifa e shërbimit:	378.56 bruto
Raporton te:	Zyra rajonale në Prishtinë
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta–(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Tre (3) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK- 1

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1 Sigurimin e formularëve, kontrollimi dhe plotësimi i formularëve te responenteve,
- 2.Shpërndarja e formularëve dhe pranimin e tyre,

3. Angazhimi në përcjelljen e çmimeve të produkteve të konsumit të gjerë ,
4. Grumbullon , kontrollon dhe azhuron të dhënat e buxhetit familjar në regjionin e Prishtinës dhe te njëjtat ju përcjellë shërbimeve gjegjëse në ASK-se.,
5. Angazhimi në anketën e fuqisë punëtore si dhe në anketën e biznesit te ndërmarrjeve, bujqësisë,
6. Angazhimi në regjistrimin e qarqeve statistikore , ekonomive familjare,
7. Grumbullon , kontrollon dhe azhuron te dhënat e demografisë se regjionit te Prishtinës dhe te njëjtat ju përcjelle shërbimeve gjegjëse ne ES te Kosovës.
8. Për punën e vet i përgjigjet eprorit të drejtëpërdrejt.

Kualifikimi :

-Diploma e shkollës së mesme apo student i fakultetit (e preferuar)

Përvoja e punës: e preferueshme

Kompetenca dhe aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel, Outlook) ,

-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,

-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarikë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në ueb faqen e ASK-së.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivën e ASK-së, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të

Kosovës , Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. **Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 - 16:00.